



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 qershor 2024  
Nr. ref.: RK 2456/24

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI286/23

Parashtrues

**Feride Marevci**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 380/2023]  
të 2 tetorit 2023, të Gjykatës Supreme**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka - Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Feride Marevci, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 380/2023] e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) të 2 tetorit 2023.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenet 14 (Ndalimi i Diskriminimit) dhe 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 26 dhjetor 2023, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Gjykata).
6. Më 16 janar 2024, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI286/23 caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe me Vendimin KSH. KI286/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 19 janar 2024, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje të kërkesës së parashtrueses iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 30 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesja e kërkesës ishte në marrëdhënie pune me kompaninë e sigurimeve "Dardania" në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: punëdhënësi), nga 1 marsi 2003 deri më 14 janar 2010 kur bëri kërkesë për shkëputje të kontratës së punës. Parashtruesja e kërkesës pretendonte se nga 1 janari 2008 deri më 2 shkurt 2009, punëdhënësi ia realizoi vetëm 50 për qind të pagës së përcaktuar me kontratën e punës, me arsyetimin se pjesën tjetër do t'ia realizonte pasi të përmirësohej gjendja financiare. Parashtruesja e kërkesës bëri dy kërkesa te punëdhënësi, më 14 janar 2010 dhe 8 qershor 2012, përmes së cilave kërkonte shumën e pagave të porealizuara, por nuk mori përgjigje.

11. Më 10 korrik 2012, parashtruesja e kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër punëdhënësit, përmes së cilës kërkonte që të detyrohej punëdhënësi t'ia paguante pagat e porealizuara në vlerën prej 4.563.00 (katërmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) euro.
12. Punëdhënësi e kundërshtoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe arsyetoi se përmes një vendimi të Bordit se pagat e të gjithë punonjësve ishin zbritur në vlerën prej 50 për qind. Punëdhënësi theksoi se punëtorët e prekur nga ky vendim kishin mundësi të parashtronin ankesë ndaj atij vendimi mirëpo nuk e kishin bërë. Sipas punëdhënësit, bazuar në nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës kërkesa e parashtrueses së kërkesës ishte parashkruar, pasi afati për parashtrimin e kërkesës për këto çështje është 30 ditë.
13. Më 17 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C. nr. 1878/12] miratoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës; detyroi punëdhënësin t'ia kompensonte pagat e porealizuara për periudhën nga 1 marsi 2008 deri më 28 shkurt 2009 në shumën prej 4.563.00 (katërmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) euro, trustin e kursimeve pensionale në shumën prej 565.00 (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro dhe tatimin në shumën prej 367.90.00 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e nëntëdhjetë cent). Gjykata Themelore arsyetoi se sipas nenit 87 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 (tri) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërkaq neni 371 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton se kërkesat parashkruhen për 5 (pesë) vjet, nëqoftëse me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit. Gjykata Themelore theksoi se *“padiësja me padi kërkon realizimin e kërkesave nga marrëdhënia e punës në para dhe afati ligjor për parashkrimin e kërkesave të tilla sipas Ligjit të Punës përbënë afat 3 vjeçar”* dhe e *“ka ushtruar padinë brenda këtij afati”*.
14. Punëdhënësi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të Gjykatës Themelore për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 23 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 781/16] e miratoi ankesën e punëdhënësit; prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ktheu çështjen në rivendosje. Gjykata e Apelit arsyetoi se *“gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë përkitazi me vendimin e uljes së pagës, sepse gjykata nuk i ka hetuar në masë të mjaftueshme gjendjen e fakteve dhe në shkresat e lëndës nuk ka vendim për uljen e pagës, që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk e ka administruar si provë, edhe përkundër faktit që e ka aprovuar padinë”*. Gjykata e Apelit theksoi se në *“riprocedurë gjykata t'i evitoj shkeljet e sipërtheksuara, në atë mënyrë që në shqyrtimin kryesor të administrojë provat për faktet vendimtare dhe provat e propozuara nga palët ndërgjyqësore”*.
16. Më 23 korrik 2020, Gjykata Themelore në rigjykim aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës; detyroi punëdhënësin që t'ia paguajë parashtrueses së kërkesës kompensimin financiar në shumën prej 4.563.00 (katërmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) euro, kamatën vjetore prej 8 për qind, pagesën e kontributit pensional në shumën prej 565.00 (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro dhe tatimin në shumën prej 367.90 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e nëntëdhjetë cent). Gjykata Themelore argumentoi se në bazë të raportit bankar vërehet se punëdhënësi nuk e ka paguar parashtruesen e kërkesës sipas vlerës së përcaktuar në kontratën e punës, por 50 për qind më pak. Gjykata theksoi se punëdhënësi nuk paraqiti asnjë vendim të bordit përmes së cilit pretendonte se ishte ulur paga për të gjithë punonjësit për 50 për qind. Pasi që ulja e pagës ishte bërë pa ndonjë vendim, parashtruesja e kërkesës nuk kishte mundësi ta kundërshtonte atë.

17. Punëdhënësi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
18. Më 12 qershor 2023, Gjykata e Apelit e aprovoi si të bazuar ankesën e punëdhënësit. Gjykata e Apelit arsyetoi se sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, “*të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit theksoi se paga e parashtrueses së kërkesës ishte zvogëluar më 1 mars 2008, ndërkaq parashtruesja e kërkesës kërkesëpadinë e dorëzoi më 12 korrik 2012, pra jashtë afatit ligjor prej 3 vitesh. Gjykata theksoi se edhe nga 28 shkurti 2009 kur parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesë të punëdhënësi për realizimin e diferencës së pagave, e deri më 12 korrik 2012 kur e paraqiti kërkesëpadinë, kishte kaluar afati 3 vjeçar.
19. Parashtruesja e kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 2 tetor 2023, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykata Supreme u pajtua me interpretimin e Gjykatës së Apelit se kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor prej 3 vitesh.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesja e kërkesës thekson se kërkesëpadia e saj ishte paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar nga neni 87 i Ligjit të Punës, që përcakton se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës.
22. Parashtruesja e kërkesës thekson se, Gjykata e Apelit në shqyrtimin e ankesës në herën e parë nuk e përmendi fare çështjen e parashkrimit të kërkesëpadisë, mirëpo në procesin e rigjykimit e refuzon kërkesëpadinë pikërisht për shkak të parashkrimit.
23. Parashtruesja e kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e interpretuan në mënyrë të gabuar nenin 87 të Ligjit të Punës, duke ia shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuar nga neni 24 dhe 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
24. Parashtruesja e kërkesës thekson se konstatimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme se parashtrueses së kërkesës i është zvogëluar paga nga 1 marsi 2008 dhe e njëjta ka vazhduar punën, është konstatim jo i drejtë dhe i paqëndrueshëm, sepse 1 marsi 2008 nuk konsiderohet data e paraqitjes së kërkesës, siç parashihet nga neni 87 i Ligjit të Punës.

### **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

#### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

##### ***Neni 24***

##### ***[Barazia para Ligjit]***

*1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

*[...]*

##### ***Neni 31***

**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
[...]

**LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS**

**Neni 87**

**Afati i parashkrimit**

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

**LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE**

**NËNKREU 2**

**AFATI I PARASHKRIMIT**

**Neni 352**

**Afati i përgjithshëm i parashkrimit**

Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.

**Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

25. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

**Neni 113**

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

**Neni 21**

[Parimet e përgjithshme]

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

27. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

**Neni 47**

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.



2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

28. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 380/2023] e Gjykatës Supreme të 2 tetorit 2023, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
29. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2), të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39

[Kriteret e pranueshmërisë]

(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

[...]

30. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin

e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kem mache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, Vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

### **Në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së**

31. Parashtruesja e kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e interpretuan në mënyrë të gabuar dispozitën e Ligjit të Punës në lidhje me parashkrimin e kërkesëpadisë, duke shkelur të drejtën për një proces të rregullt dhe të paanshëm gjyqësor.
32. Gjykata rithekson se nuk është gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk e ka për detyrë të merret me gabimet e faktit ose të interpretimit të gabuar të ligjit që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, e as të rishikojë konstatimet e gjykatave të rregullta. (rasti i Gjykatës, [KI81/20](#), parashtrues *Arbër Shkreli*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 majit 2021, para. 45-46; [KI116/20](#), parashtrues *N.T.Sh. “Edita-S.O.K”*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2021, para. 33-35). Gjykata mund të ndërhyjë në rastet kur vendimet e gjykatave të rregullta janë “dukshëm arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” në dëm të parashtruesve të kërkesës. (rasti i Gjykatës, [KI145/20](#), parashtrues *Hafize Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, para. 33-35; [KI83/21](#), parashtrues *Çerkin Ibishi*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2022, para. 43-44).
33. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ishte në marrëdhënie të punës me punëdhënësin nga 1 marsi 2003 deri më 14 janar 2010, kur bëri kërkesë për shkëputje të marrëdhënies së punës. Në kontratat e punës, të lidhura ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe punëdhënësit, përcaktohej që paga e parashtrueses së kërkesës do të ishte në shumën prej 900 respektivisht 800 euro. Mirëpo, nga 1 marsi 2008 punëdhënësi ia realizoi parashtrueses së kërkesës pagën 50 për qind më pak sesa shuma e përcaktuar në kontratat e punës. Një gjë e tillë nuk ishte kontestuese ndërmjet palëve. Megjithatë, punëdhënësi u arsyetua që parashtruesja e kërkesës e kishte ditur vendimin për ulje të pagës dhe nuk e kishte kundërshtuar atë, prandaj kërkesa e saj ishte parashkruar. Në anën tjetër, parashtruesja e kërkesës u arsyetua se punëdhënësi kishte premtuar se pas përmirësimit të gjendjes financiare do t’ia kompensonte diferencën e pagave të porealizuara.
34. Gjykata vëren se, Gjykata Themelore në dy vendimet e saj, përfshirë vendimin në rigjykim, vendosi në favor të parashtrueses së kërkesës duke e detyruar punëdhënësin që t’ia kompensojë parashtrueses së kërkesës diferencën e pagave të porealizuara. Gjykata Themelore vlerësoi se punëdhënësi nuk kishte marrë asnjë vendim formal për uljen e pagave të punonjësve të saj, prandaj parashtruesja e kërkesës nuk kishte mundësi të kundërshtonte një vendim i cili në fakt nuk ekzistonte fare. Po ashtu, Gjykata Themelore theksoi se sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, që në rastin konkret nuk ishte parashkruar kërkesa e parashtrueses së kërkesës.
35. Gjykata e Apelit, më pas Gjykata Supreme, nuk u pajtuan me vlerësimin e Gjykatës Themelore dhe refuzuan kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se ishte parashkruar. Të dyja këto instanca argumentuan se, përkundër që nuk kishte një vendim formal të punëdhënësit për zbritjen e pagës në 50 për qind, parashtruesja e



kërkesës ishte në dijeni që paga e saj po ekzekutohej më pak sesa ishte e përcaktuar në kontratat e punës dhe nuk mori asnjë veprim për ta kundërshtuar një gjë të tillë. Në lidhje me afatin e parashkrimit, gjykatat e rregullta arsyetuan se, nga 1 marsi 2008 kur parashtruesja e kërkesës ishte në dijeni për zvogëlimin e pagës, e deri më 12 korrik 2012 kur e parashtruesja e kërkesës kishte kaluar afati prej 3 vitesh për paraqitjen e kërkesës nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohet nga neni 87 i Ligjit të Punës, rrjedhimisht kërkesa ishte parashkruar.

36. Parashtruesja e kërkesës e kundërshton arsyetimin e gjykatave të rregullta dhe konsideron që e interpretuan në mënyrë të gabuar nenin 87 të Ligjit të Punës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, i cili parasheh që afati i parashkrimit për të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.
37. Gjykata thekson se çështja e parashkrimit të kërkesës nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohet nga Ligji i Punës, u vlerësua nga gjykatat e rregullta të cilat e kanë autoritetin për ta bërë një vlerësim të tillë dhe Gjykata nuk mund ta kontestojë atë. Gjykatat e rregullta i arsyetuan mjaftueshëm vendimet e tyre në lidhje me parashkrimin e kërkesës dhe nuk morën vendime arbitrare apo qartazi të paarsyeshme.
38. Gjykata thekson se gjatë procesit gjyqësor, në të gjitha instancat, parashtruesja e kërkesës kishte mundësi të paraqiste të gjitha provat dhe argumentet e saj në lidhje me kontestin e punës. Parashtruesja e kërkesës përmes kërkesëpadisë në Gjykatën Themelore, revizionit në Gjykatën Supreme dhe përgjigjeve ndaj ankesave të punëdhënësit, pati mundësinë dhe në fakt i adresoi të gjitha çështjet, përfshirë edhe parashkrimin e kërkesës. Parashtruesja e kërkesës nuk ngre asnjë të metë procedurale që ka mundur ta cenonte rregullsinë e procesit gjyqësor dhe ta vendoste atë në pozitë të pafavorshme me palën kundërshtare.
39. Gjykata thekson se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me parashkrimin e kërkesës nga marrëdhënia e punës, i përkasin pretendimeve të “*shkallës së katërt*”, dhe duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara.




## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 30 prill 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtarja raportuese**



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani